



**FETVA PYETJE ? SQARIME PËRGGJIGJE**  
 Rreth Ramazanit Në çdo kohë gjatë 24 orëve të ditës  
**067 260 8302**

Allahu im, për Ty kam agjëruar, Ty të besoj, tek Ti mbështetem dhe me të mirat Tua bëj iftar. Etja u shua, dejt e gjakut u freskuan dhe shpërblimi u shënuar, nëse do Zoti.



# LIDHJA

ORGAN I LIDHJES SË HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË Viti 3 - Nr. 28 e Premte 27 Qershor 2014 / 29 Sha'ban 1435

## Ramazani, muaji i solidaritetit social



Muaji Ramazan është një muaj i bekuar, i cili vjen për pasurimin e shpirtit dhe të zemrës me besim dhe shumë vrytje të larta njerezore dhe kjo nëpërmjet devotshmërisë, e cila është qëllimi kryesor i këtij obligimi hyjnor.

Nëpërmjet agjërimit të këtij muaji të shenjtë besimtari arrin të përmirësojë qënien e tij, besimin e tij sjelljet e tij,

moralin e tij dhe gjithçka i duhet të paiset me të për të qenë një njeri model.

Ky muaj i begatë, përveç të mirave shpirtërore dhe shpërblimit pa llogari i cili do të rëndojë shumë në peshore Ditën e Gjykimit, ka një ndikim social dhe ekonomik në shoqëri, nëpërmjet rregullave dhe dizpozitave që posedon. Në këtë muaj agjeruesit e pasur

prej besimtarëve përballen me urinë dhe etjen, gjë e cila i bën të mendojnë më shumë për vuajtjet e të varfërve, kështu që zemrat e tyre zbuten dhe kjo konkretizohet me sadakanë dhe ndihmën ekonomike.

Kështu që në këtë muaj, i cili e ngre lart moralin e besimtarit, ndihmohet i varfëri, jetimi, gratë e veja, dhe të moshuarit. (Vijon në faqen 7...)

### HAPJA E RESTORANTEVE GJATË DITËS NË MUAJIN E RAMAZANIT

**Pyetje:** A lejohet hapja e restoranteve dhe picerive gjatë kohës së agjërimit në ditët e Ramazanit?

**Përgjigje:** Agjërimi i Ramazanit është detyrim për çdo musliman që ka plotësuar kriteret që parashtron feja islame për këtë obligim. Respektimi i shenjtërisë së këtij muaji është gjithashtu obligim për besimtarët, ndaj hapja e restoranteve, picerive dhe çdo lokali tjetër që ofron ushqim dhe pije si konsum i menjëhershëm gjatë ditëve të Ramazanit,

(Vijon në faqen 2...)

### OAZI I SHPIRTIT

Profeti, paqia dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, për agjërimin e Ramazanit thotë:

- “Erdhi tek ju muaji i Ramazanit, një muaj i bekuar dhe i begatë. Muaj në të cilin Allahu ka bërë obligim agjërimin. Në këtë muaj hapet dyert e qiellit, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe shejtanët rebelë do të prangosen. Në këtë natë ndodhet një natë që është më e mirë se njëmijë muaj. Kush nuk e arrin këtë natë (me adhurime) do të jetë i privuar nga mirësitë e saj.” Ahmedi dhe Nesaiu.

- “Kush agjëron muajin e Ramazanit me besim të plotë tek Allahu duke pritur shpërblimin prej Tij, (Vijon në faqen 3...)

### Lidha e Hoxhallarëve të Shqipërisë organizoi seminarin e dytë me temë: ORIENTIME TË NEVOJSHME PËR THIRRËSIT ISLAM

Në datat 13-17 Qershor të këtij viti, në ambientet e fshatit turistik të Llogorasë, Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë, në bashkëpunim me Ligën e Botës Islame, me qendër në Mekë, si edhe me pjesëmarrjen e rreth gjashtëdhjetë hoxhallarëve nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, organizoi seminarin e dytë të ciklit “Orientime të nevojshme për thirrësit islam”. Ky seminar tre ditor ishte i mbushur me ligjërata, diskutime dhe aktivitete të tjera, qëllimi kryesor i të cilave ishte ngritja e nivelit intelektual dhe fetar të hoxhallarëve në lëminë e doktrinës islame, predikimit, historisë profetike dhe forcimi i vëllazërisë islame. Në këtë seminar morën pjesë dhe ligjëruesit profesorët e nderuar nga Universiteti “Umul Kurra” i Mekës: Dr. Muhamed es-Sulemi, Dr. Abdullah el-Karni si dhe përfaqësuesit zyrtar Ligës z. Ibrahim Bahiti, të cilët me anë të temave të ndryshme që trajtuan në mesin

e të pranishmëve, vunë një gur më tepër në përmbushjen e një nga synimeve kryesore të aktivitetit të LSHH-së, që është ngritja e nivelit fetar dhe kulturor të hoxhallarëve në përgjithësi dhe në çështje dhe problematika bashkëkohore në veçanti.

Ky aktiviteti zhvillohet në vazhden e bashkëpunimit midis Lidhjes së Hoxhallarëve të Shqipërisë dhe Ligës së Botës Islame. Seminari në fjalë përveç përmirësimit dhe konkretizimit të njohurive të marra, iu shërbeu të pranishmëve edhe për t’u njohur dhe çmullur me njeri-tjetrin, ai u dha mundësi atyre të diskutojnë ndërmjet tyre për çështje të ndryshme në lidhje me shqetësimet dhe problematikën që ata hasin në jetën dhe punën e tyre islame. Këto njohje dhe eksperiencat shpresojmë t’iu shërbejnë atyre në punën dhe obligimet e tyre të përditshëm, njohuri nga të cilat do të përfitojnë edhe besimtarët e thjeshtë që mbushin xhamitë e vendit tonë. Në fund të këtij seminarin të gjithë të pranishmëve iu shpërnda nga një certifikatë prezence nga përfaqësuesit e Ligës së Botës Islame dhe LSHH. Përgatiti Kelmend Baçi

**LSHH** **MBLEDH ZEKATIN TUAJ**

Për zekatin në lekë:  
 IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB  
 Llogaria në lekë:  
 IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA  
 Llogaria në Euro:  
 IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO  
 Llogaria në Dollarë:  
 IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë  
 Tel: 0672304520 /0672538334/048320160  
 BKT Banka Kombëtare Tregtare  
 Nr. i llogarisë : 52416329

**Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë i uron mbarë besimtarëve Muslimanë agjërim të lehtë e të pranuar**

## Pyetje dhe Fetva/

### SI VËRTETOHET HYRJA E MUAJVE HËNORË

**Komisioni i Përhershëm i Fetvave në Mbretërinë e Arabisë Saudite, Fetvaja nr 2031 v.10 fq. 83**

**Pyetje:** Me cilën metodë vërtetohet hyrja e muajve të kalendarit hënor?

**Përgjigje:** Hadithet e sakta që përcillen nga Profeti (alejhissalatu uesselam) tregojnë se nëse ndonjëri nga besimtarët e besueshëm e shikon hilalin (hënën e re) pas përfundimit të Diellit në natën e 30 të muajit Sha'ban, ose disa besimtarë të besueshëm në natën e 30 të muajit Ramazan, atëherë ky lloj shikimi konsiderohet i rregullt dhe i pranuar. Me këtë mënyrë vërtetohet fillimi i muajit të ri në kalendarin hënor pa marrë parasysh kohëzgjatjen e shfaqjes së hënës së re pas përfundimit të Diellit, 20 minuta, ose me pak ose më shumë, sepse në hadithet e sakta nuk përcaktohet kjo kohë me minuta ekzakte. Këtë që përmendëm e ka konfirmuar dhe Këshilli i dijetarëve të mëdhenj në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

**Komisioni i Përhershëm i Fetvave në Mbretërinë e Arabisë Saudite, Fetvaja nr 386 v.10 fq. 83**

**Pyetje:** A lejohet për muslimanin të mbështetet për fillimin e muajit të Ramazanit në llogaritjet astronomike apo duhet patjetër të shikimin e hilalit (hënës së re) me sy të lirë?

**Përgjigje:** Sheriati islam është një fe që karakterizohet me lehtësime, ka rregulla dhe dispozita gjithpërfshirëse për njerëzit dhe xhinët mbarë dhe përmban të gjitha kategoritë e njerëzve, të diturit dhe analfabetët, qytetarët dhe fshatarët. Për këtë arsye Allahu i Madhëruar e ka lehtësuar rrugën e njohjes së kohëve të adhurimeve duke vendosur dhe përcaktuar për futjen dhe daljen e kohëve të adhurimeve shenja të përbashkëta që mund të njihen nga të gjithë. Kalimin e diellit përshembull nga kupa e qiellit për nga ana e përfundimit e ka bërë shenjë dalluese për hyrjen e kohës së drekës, sic ka bërë përfundimin e diellit shenjë dalluese për hyrjen e kohës së akshamit dhe zhdukjen e muzgut të kuq shenjë dalluese për hyrjen e kohës së jacisë. Po ashtu ka bërë hilalin (hënën e re) shenjë dalluese për futjen e muajve të kalendarit hënor (lunar), ndërkohë nuk ia ka lënë cështjen në dorë vec një pakice të njerëzve që mund të kenë njohuri në llogaritjet astronomike. Për këtë dëshmojnë argumentet e ndryshme në Kuran dhe në sunet të cilat tregojnë se të dëshmuarit dhe të parit e hilalit (hënës së re) me sy të lirë është shenjë dalluese për fillimin e agjërimit për muslimanët në muajin e Ramazanit si dhe përfundimin e agjërimit me rastin e pamjes së hilalit të muajit Shevval. Me të njëjtën mënyrë përcaktohet dhe dita e Kurban Bajramit dhe dita e Arafatit. Allahu i Lartësuar në Kuran thotë: "Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë!" Surja El-Bekare 185. Në një ajet tjetër thotë: "Të pyesin ty (o Muhamed) për hënën e reja; thuaju: "Ato janë për njerëzit shenja përcaktuese të kohës dhe të haxhillëkur". Surja El-Bekare 189. Ndërsa Profeti (alejhissalatu uesselam) thotë: "Kur ta shikoni hënën e re agjëroni dhe kur ta shikoni hënën e re (të muajit tjetër) ndërpriteni

agjërimin e nëse pengoheni nga pamja e hënës së re atëherë plotësojeni muajin Sha'ban 30 ditë." Transmetuan Buhariu dhe Muslimi. Shikojmë që Profeti (alejhissalatu uesselam) fillimin dhe mbarimin e agjërimit e lidh me të shikuarit e hënës së re me shikim të lirë dhe jo duke u mbështetur në përllogaritjet astronomike. Kështu kanë ecur dhe punuar muslimanët në kohën e Profetit (alejhissalatu uesselam), në kohën e katër khalifëve të drejtë, në kohën e katër imamëve të njohur (medh'hebeve) dhe në tre shekujt e parë të islamit, shekujt të cilat i ka lavdëruar vetë Profeti (alejhissalatu uesselam).

Atëherë themi se mbështetja për fillimin dhe përcaktimin e muajve hënor në llogaritjet astronomike për fillimin dhe daljen nga adhurimet e ndryshme është risi (bidat) në të cilin nuk ka mirësi dhe nuk ka mbështetje në sheriati islam.

### HAPJA E RESTORANTEVE GJATË DITËVE TË MUAJIT RAMAZAN!

**Pyetje:** A lejohet hapja e restoranteve dhe picerive gjatë kohës së agjërimit në ditët e Ramazanit?

**Përgjigje:** Agjërimi i Ramazanit është detyrim për çdo musliman që ka plotësuar kriteret që parashtron feja islame për këtë obligim. Respektimi i shenjtërisë së këtij muaji është gjithashtu obligim për besimtarët, ndaj hapja e restoranteve, picerive dhe çdo lokali tjetër që ofron ushqim dhe pije si konsum i menjëhershëm gjatë ditëve të Ramazanit, është një çështje që ka të bëjë pikërisht me ruajtjen e shenjtërisë së muajit të Agjërimit.

Nisur nga detyrimi që ka çdo musliman për të respektuar shenjtërinë e këtij muaji ne gjykojmë se nuk lejohet që këto lokale të mbahen hapur gjatë ditës, pra gjatë kohës kur kryhet agjërimi. Hapja dhe shërbimi i ushqimeve në to gjatë kohës së agjërimit konsiderohet bashkëpunim në gjynah, sepse u ofron ushqim atyre që e kanë detyrë të agjërojnë, paçka se shumë prej njerëzve e kanë vendosur të mos agjërojnë. Allahu i Madhëruar thotë: "Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqtësi!" Surja el-Maide 2.

Po kështu hapja dhe servirja e ushqimit në këto lokale gjatë ditëve të agjërimit nga ana e muslimanëve jep një imazh jo të mirë në sytë e besimtarëve dhe të mbarë njerëzve.

Lejohet që këto lokale gjatë kohës së agjërimit të përgatisin ushqim, pica etj, nëse u kërkohet nga dikush që do ti konsumojë ato pas iftarit, gjithashtu i lejohet të përgatisë ushqim me porosi nga ata persona që janë të arsyetuar dhe se kanë detyrë agjërimin siç janë udhëtarët, të sëmurët, pleqët e thyer në moshë, fëmijët, gratë me cikël menstrual, etj. Ndërkohë lejohet përgatitja e ushqimeve para iftarit që të jenë të gatshme në kohën kur çelet iftari e më pas, për të gjithë kategoritë e njerëzve.

Ne këshillojmë që këtë ta bëni për hir të Allahut duke kërkuar shpërblimin e Tij dhe duke qenë të sigurtë se kush e lë diçka për hir të Allahut, Allahu do t'ia zëvendësojë me diçka më të mirë se ajo që ai ka lënë".

Allahu e di më së miri!

**Komisioni i studimeve dhe i fetvave pranë LSHH-së**

### KUSH E KOMPENSON AGJËRIMIN

**Pyetje:** Një person, që e njoh personalisht, është shumë dembel në adhurime (namaz,

agjërim etj) falet me hope, por ai njësion Allahun. Është i sëmurë, por jo në gjendje sa të mos agjërojë dhe do që të japë kompensim, pra i bie shkurt (do ta kompensojë me ushqimin e një të varfëri), a i merret këtij personi ky kompensim apo jo? Ai thotë se nuk mundet se është me ilaçe? (Ka ca ilaçe të tensionit dhe është djalë i ri, nuk e merr mundimin të agjërojë dhe ta provojë një herë).

**Përgjigje:** Muslimani i cili e ka për detyrë të jap kompensim në ushqim për varfrit, në rast se ai nuk agjëron Ramazanin, është ai njeri që vuan nga një sëmundje e pashërueshme kronike, pra nuk shpresohet të shërohet, dhe agjërimi e dëmton atë apo i vë në rrezik jetën. Për këtë duhet marrë parasysh edhe këshilla e mjekut specialist. Në të kundërt nëse sëmundja është e lehtë, ai duhet ta mbajë agjërimin, dhe vetëm e ndjen realisht se po e dëmton, atëherë mund ta prishe atë ditë dhe ta kompensojë me vone atë ditë me agjërim jashtë Ramazanit. Këtë gjë duhet ta kuptojë vetë i sëmuri, pra se kur e ka sëmundjen të lehtë, e kur e dëmton dukshëm atë (Esherhul mumti). Nëse kompensimi jepet nga njëri që nuk plotëson atë përmendëm, atëherë ajo që ai jep nuk konsiderohet kompensim në realitet dhe nuk ia heq obligimin e agjërimit, sepse është një veprim që nuk kryhet në vendin e duhur, por ky veprim konsiderohet vetëm si sadaka. Ky musliman duhet të këshillohet që ai të falet rregullisht, sepse namazi është shtylla e Islamit dhe gjëja e parë për të cilën do të pyetet njeriu në Ditën e Kijametit.

Allahu e di më së miri!

**Komisioni i studimeve dhe i fetvave pranë LSHH-së**

### KOMPESIMI I AGJËRIMIT

**Pyetje:** Një person që është musliman dhe do të agjërojë, por në pamundësi të shëndetit të tij të keq pra (është i sëmurë dhe merr ilaçe). Do të japë kompensim pra të ushqejë të varfër si e jap këtë kompensim në lek apo ushqim? Sa? Dhe kur e jep (për çdo ditë, në fillim, apo në fund)?

**Përgjigje:** Kompensimi për shlyerjen e agjërimit jepet në ushqim, nga ata muslimanë që kanë sëmundje kronike ose janë të thyer në moshë dhe nuk mundin të agjërojnë. Nga sahabi i nderuar Enes ibn Malik, (Allahu qofte i kënaqur prej tij!) përcillet se kur ai shkoi në moshë të thyer dhe e kishte të pamundur të agjëronte, grumbulloi tri dhjetë të varfër në një ditë dhe u shtroi ushqim për të ngrënë. Këtë njeriu kompensim i interesuar mund ta japë vetë ose mund të ngarkoj dikë tjetër për ta bërë këtë gjë për të. Kompensimin mund ta japë për çdo ditë të Ramazanit, ose në fund të Ramazanit. Ai jepet në dy mënyra:

a) nga një vakt ushqim për aq ditë sa nuk ka agjëruar.

b) ose mund ta japë ushqim të pa gatuar (të paktën gjysmë sa', e barabartë kjo me masën e dy grushteve, prej artikujve ushqimor, si: oriz, fasule, etj., ose një grusht miell). Kompensimi i agjërimit në pamundësi mund të jepet edhe në vlerë monetare, por me kusht që kjo vlerë të shkojë për ushqim. Kostoja e këtij ushqimi ndryshon në varësi të mundësisë ekonomike dhe ushqimit që konsumon vetë personi që duhet të japë kompensimin e agjërimit. Sipas një llogaritje të përafërt në lekë, në kohën që jetojmë, kjo shumë për ushqim të gatuar për Shqipërinë mund të shkojë së paku tek 250-300 lekë të reja, e mjaftueshme kjo për ushqimin një vakti të thjeshtë ngrënie për një njeri, kështu që për 30 vakte ushqimi shuma shkon në 8000 apo 9000 lekë të reja, por nëse kjo shumë jepet për blerjen e një ushqimi të pagatuar do të ishte më mirë, sepse i bie një sasi më e madhe dhe në këtë rast është ka më shumë interes për njerëzit nevojtarë.

Allahu e di më së miri!

**Komisioni i Pyetje-Përgjigjeve pranë LSHH**

### PASIMI I IMAMIT GJATË TERAVIVE

**Pyetje:** Selam Alejkum, hadithet që flasin për pasimin e imamit në namaz a kan për qellim vetem pasimin e imamit gjatë namazit dmth veprimet që ai kryen apo kan për qellim edhe ... p.sh. namazin e taravive dikush e fal 20 rekate e dikush 8. Nëse imami i fal 20 rekate a quhet mospasim i imamit nese dikush i fal 8? (A ka hadithe te tilla per kete gje?) A konsiderohet mospasim i imamit nese imami gjate namazit nuk i ngrit duart kur bie ne ruku ose kur ngritet kurse dikush i ngrit dhe gjera te ngjashme? Allahu ju shperbleft me t'mira!

**Përgjigje:** Me emrin e Allahut. Salevatet qofshin për Profetin tonë.

Hadithi kryesor që flet për këtë temë është hadithi i Ebu Hurejres që e përcjell Buhariu (nr. 734) dhe Muslimi (nr. 414) ku Profeti (alejhissalatu uesselam) thotë: "Vërtetë, imami është bërë që të ndiqet në namaz." Kjo do të thotë që ai duhet të ndiqet në strukturën e përgjithshme të namazit, siç na mëson vetë vijimi i hadithit, ku thuhet: "Kur imami thotë: "Allahu ekber" Edhe ju thoni ashtu. Kur imami bie në ruku, bini dhe ju, e kur të bjerë në sexhde, shkoni dhe ju pas tij..." Kuptimi i gjithë kësaj është se imami duhet të ndiqet në strukturën e namazit, duke mos i bërë veprimet para tij. Këtë na e provojnë edhe transmetime të tjera te Nesaiu, Ibn ebi Shejbe, Bejhekiu etj, ku Profeti (alejhissalatu uesselam) e ka vijuar hadithin duke thënë: "sepse, është imami ai që duhet të bjerë në sexhde para jush dhe duhet të ngrihet para jush." Kjo gjithashtu sqarohet edhe nga Imam Maliku, i cili pasi e transmeton këtë hadith në Muvattan e tij, menjëherë na përcjell fjalën e Ebu Hurejres, i cili thotë: "Koka e atij që e ngre dhe e ul kokën para imamit, është në dorë të shejtanit."

Pra, nga e gjithë kjo mund të themi se, nëse imami lë sunete të ndryshme gjatë namazit, bie fjala, nuk i ngre duart në tekbinin para dhe pas rukusë ose nuk e ngre gishtin në teshehud etj, nuk duhet ndjekur dhe pasuar në këto veprime të tij, por çdo njeri duhet t'i zbatoje ato sunete më vete. Po ashtu, siç shihet hadithi i Ebu Hurejres nuk ka për qëllim ndjekjen e imamit në numrin e rekateve gjatë namazit të taravive, sepse hadithi ka ardhur për të shpjeguar diçka tjetër. Kurse, për sa i përket namazit të taravive, mund të përmendim një hadith tjetër, që e përcjell Tirmidhiu (nr. 806) dhe Ebu Davudi (nr. 1375) ku Profeti (alejhissalatu uesselam) thotë: "Kush falet bashkë me imamin derisa ai të përfundojë, do të shpërblehet si të ishte falur gjithë natën." Ky hadith tregon qartë se, është e pëlqyeshme dhe jo e detyrueshme të falësh pas imamit në namazin e taravive. Pra çdo kush mund të shkëputet nga namazi kur të dojë dhe s'ka asnjë ndalesë për këtë gjë edhe pse më e pëlqyeshme është ajo që përmendëm. Allahu e di më së miri!

**Komisioni i studimeve dhe i fetvave pranë LSHH-së**

### FETVA DHE SQARIME NË 24 ORË, GJATË MUAJIT TË RAMAZANIT

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë, këtë vit në muajin e shenjtë të Ramazanit, vendos në dispozicion të agjëruësve numë telefoni.

Gjatë gjithë Ramazanit hoxhallarët e komisionit të fetvave do t'i përgjigjen telefonuesve në kohë reale. Mos hezitoni:

**0672608302**

Bordi botues:  
Justinian TOPULLI  
Genc PLUMBI  
Mustafa TËRNIQI

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: "Teodor Keko" Pallati Edglis, Tiranë-Shqipëri  
lidhjehoxhallareve@yahoo.com  
Tel & Fax: +355 (0)48320160  
http://www.lidhjehoxhallareve.com

# Ramazani dhe rregullat e agjërimit

Agjërimitin e Ramazanit e ka detyrë çdo mysliman, që ka arritur moshën e pjekurisë (pubertetin), i cili është i shëndoshë fizikisht e mendërisht dhe është rezident (jo udhëtar), në një vend. Kjo do të thotë se agjërimitin nuk e kanë detyrë:

- 1- Fëmijët, të cilët nuk kanë mbushur moshën e pjekurisë.
- 2- Njeriu me të meta mendore.
- 3- I sëmurë që vuan nga sëmundje të përhershme ose të pashërueshme. Ky gjykim vlen edhe për pleqtë e thyer në moshë, të cilët nuk mund ta përballojnë dot agjërimitin. Ndërsa personat e sëmurë përkohësisht, e ndërpresin agjërimitin për aq ditë sa janë sëmurë dhe pastaj i agjërojnë ato kaza (në muajt e tjerë), kur të bëhen mirë.

Në këtë kategori futen edhe gratë shtatzëna të cilat kanë frikë përkeqësimin e shëndetit të tyre

ose të foshnjes në bark, si dhe gruaja gjdhënëse e cila ka frikë për shëndetin e saj, apo të fëmijës së vogël. Të dyja këto kategori mund ta ndërpresin agjërimitin dhe ta zëvendësojnë atë me vonë.

4- Gruaja me cikël menstrual dhe gruaja lehonë. Ato duhet t'i zëvendësojnë ato ditë me pas.

5- Udhëtarë, i cili kryen udhëtime të gjata, mirëpo ai duhet t'i zëvendësojë ato ditë kur të kthehet nga udhëtimi.

**Shënim:** Të sëmurët, gratë me menstruacione dhe udhëtarët nuk e kanë detyrë t'i zëvendësojnë ditët menjëherë, por kanë kohë derisa të vijë Ramazani tjetër.

## Çfarë e prish agjërimitin:

- 1- Të ngrënë dhe të pirët me qëllim: këtu futen edhe ilaçet apo çdo lloj sendi tjetër, i cili kalon në bark nëpërmjet fytyrës. Ndërsa ai që ha ose pi me harresë, ose është i detyruar,

nuk ka detyrë ta kompensojë. Profeti (alejhissalatu uesselam) thotë: **"Kush ha edhe pi gjatë agjërimit me harresë, le ta vazhdojë agjërimitin, se atë e ka ushqyer Allahu i Lartësuar."** "Transmetuan Buhariu dhe Muslimi".

2- Marrëdhëniet seksuale me vetëdije.

3- Të vjellurit me qëllim, pra duke e provokuar atë.

4- Dalja e gjakut te femra për arsye menstruale apo të lindjes. Edhe në qoftëse kjo ndodh pak çaste para se të perëndojë dielli, ajo duhet ta zëvendësojë atë ditë me pas.

5- Ejakulimi i spermës, nëpërmjet ngacmimeve vetjake apo të huaja, apo fërkimeve, puthjeve, etj.

6- Ikja e mendjes apo të rënit të fikët.

7- Futja e ujit në bark gjatë abdesit, si pasojë e neglizhencës.

8- Pirja e duhanit. 9- Serumi

## Çfarë nuk e prish agjërimitin:

1- Të ngrënë, të pirët dhe marrëdhëniet seksuale me harresë.

2- Të vjellurit pa provokim.

3- Futja e pluhurit, grimcave të rërës apo e ndonjë insekti pa dashje në bark.

4- Përdorimi i misvakut nuk e prish agjërimitin apo pastrimi i dhëmbëve me furçë, ose shpëlarja e gojës me ujë, duke pasur kujdes që të mos kalojë në bark.

5- Përdorimi i gjilpërave joushqyese për trupin, të cilat vendosen në dammar, ose në mish.

6- Përcjellja e pështymës, ose e ushqimit, që ka mbetur ndërmjet dhëmbëve, nëse (ushqimi) është shumë pak.

7- Puthja e gruas, prekja, përçafimi, etj kur njeriu arrin të përmbahet nga ejakulimi i spermës.

8- Provimi i shijes së ushqimit duke mos lejuar të kalojë gjë në bark.

## OAZI I SHPIRTIT

do t'i falen mëkatet e mëparshme". Buhariu dhe Muslimi.

• "Pesë namazet mes tyre, xhumaja deri në xhumanë tjetër dhe Ramazani deri në Ramazanin tjetër janë shlyese të mëkateve nëse i ruheni mëkateve të mëdha". Muslimi.

• Në një hadith kudsî Allahu i Madhëruar thotë: "Çdo punë e birit të Ademit është për të, përveç agjërimit, i cili është për Mua dhe vetëm Unë e shpërblej atë." Më pas Profeti a.s shtoi: "Agjërimiti është mburojë e kur ndonjëri prej jush të jetë me agjërimit, të mos flasë me fjalë të ndyra, të mos bërtasë më kot dhe të mos veprojë punë të injorancës, e nëse dikush e fyen ose e ngacmon (lufton) le ti thotë dy herë: unë jam agjërueshëm"

"Pasha atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, era e gojës së agjëruesit është më e mirë se Allahu se era e miskut. Për agjëruesit do të ketë dy gëzime, kur të çelë iftarin dhe kur të takohet me Zotin e tij". Muslimi

• "Vërtet Xheneti do të ketë një portë e cila quhet Rejjan. Ditën e gjykimit do të thirret: "Ku janë agjëruesit (për tu futur nga kjo portë)? E pasi të futet i fundit prej tyre, kjo portë do të mbyllet". Buhariu dhe Muslimi

• "Kush çohet në netët e Ramazanit të falë namaz (teravi) me besim te Allahu dhe duke e pritur shpërblimin prej Tij, do t'i falen mëkatet e mëparshme." Buhariu dhe Muslimi.

• "Kush i shtron iftar një agjëruesi do të marrë shpërblimin sikur ai që agjëron, pa ju pakësuar aspak shpërblimi i agjëruesit." Tirmidhiu.

• "Kur ta çelni iftarin çeleni me hurmë se ajo është e bekuar, e nëse nuk nuk ju gjendet, çeleni me ujë." Ebu Davudi dhe Tirmidhiu

• "Çohuni për syfyr sepse koha e syfyr është e begatë." Buhariu dhe Muslimi.



## Ditët e amnistisë hyjnore: A jemi gati?

Ditët e bekuara të Ramazanit do të kalojnë shumë shpejt. Ditët speciale të Allahut, në të cilat Ai zbrit mëshirën e Tij të madhe, faljen dhe plotëson dëshirat e besimtarëve, ndodhen në muajin e Ramazanit, kështu që gjithsecili prej nesh duhet të vlerësojë këtë muaj para se të jetë shumë vonë. Profeti Muhamed (a.s) na ka thënë se Ramazani ndahet në tre pjesë, pjesa e parë përbëhet nga mëshira e Allahut, e dyta nga falja dhe e treta nga shpëtimi prej zjarrit të zjarrit. Askush nuk e di nëse e ka fituar mëshirën e Allahut të Madhëruar në çastin kur ka mbaruar dhjetë ditëshi i parë. Duhet të jemi shumë të sinqertë me veten tonë në momentin kur shpresojmë që të fitojmë këtë dhuratë, por duhet të përpiqemi që të fitojmë dhe pjesën tjetër të bekimeve që kanë mbetur për pjesën e mbetur të muajit. Ndoshta sot që ju i lexoni këto rrjeshta jeni në fillim apo në fund të Ramazanit.

Si kemi hyrë në këto ditë? A jemi përgatitur për tu falur nga Zoti? Është çasti më i volitshëm për tu falur nga Zoti ynë dhe për tëi kërkuar falje Atij. Është një moment që nuk duhet ta humbim, nëse dëshojmë për të marrë faljen e Zotit të madhëruar kur do të na falen mëkatet tona?

Profeti Muhamed (a.s), shokët e tij dhe muslimanët e sinqertë përmes gjithë kësaj periudhe janë falur duke kërkuar mirësitë e këtij muaji. Njerëzit e mençur e dinë se kurrë s'eduhet të humbasin asnjë ditë të këtij muaji.

Pyetja më e rëndësishme që shtrohet është: **Si duhet ta kërkojmë faljen e Allahut gjatë këtyre ditëve të bekuara të Ramazanit?**

**Më poshtë po ju japim disa udhëzime:**

1. Çdokush duhet të pendohet sinqerisht para Allahut të Madhëruar, duke kërkuar faljen e Tij,

2. Nuk duhet kryer asnjë vepër e ndaluar,
3. Duhet të falim më shumë namaze nate (Tahaxhud), duhet të japim më shumë sadaka, duhet ta përmendim më shumë Zotin dhe duhet të lexojmë më shumë Kuran.

4. Nuk duhet të lëmë pas dore namazet dhe duhet tëi falim ato në vaktet e tyre.

5. Duhet ti lutemi Allahut të Madhëruar për falje dhe duhet tëi kërkojmë Atij të mos na heqë nga furnizimi i Tij.

O Allah, na ndihmo që të fitojmë mëshirën

## Duaja e Natës së Kadrit

**O Zoti im! Ti fal shumë dhe e don faljen, andaj më fal edhe mua!**

Hoxhallarët si prijës islamë duhet të jenë pararoja e çdo përpjekjeje që mund të bëhet në mbrojtje të shamisë, duke kërkuar ndihmën ligjore, mediatike dhe atë të këshillimit nga individë të caktuar në xhemat, që janë njohës të ligjeve, të medias dhe të të drejtave të njeriut.

# Ndalimi i mbajtjes së shamisë në ambientet publike dhe arsimore në trojet tona etnike

**Hoxhë Genc Plumbin**

*Drejtor Ekzekutiv pranë Lidhjes së Hoxhallarëve të Shqipërisë*

Es-Selamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu! Allahun e falënderojmë, ndërsa paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin [salAllahu alejhi ue selam]. Hoxhë i nderuar ju falënderojmë për kohën që keni ndarë për intervistën tonë, që së bashku për disa çaste të ndihmohemi në mirësi dhe devotshmëri, me qëllim të arritjes së mirësisë dhe devotshmërisë.

**- Faqja jonë “Në Mbrojtje të Shamisë” synon të merret vetëm me tematikën e të drejtës së bartjes së shamisë me fokus në trojet tona shqiptare: a mendoni se sot duhet të intensifikohen aktivitetet e xhematit, hoxhallarëve, organizatave të ndryshme dhe institucioneve fetare në mbrojtje të këtij obligimi fetar dhe a mendoni se shamia është nga simbolet e fesë që është duke u sulmuar më së shumti tek ne shqiptarët kudo që jemi?**

Ue alejkum selam ue rahmetullahi me berekatuhu!

Fillimisht falënderoj Allahun e Lartësuar që ka bërë të mundur ekzistencën e kësaj iniciative si kjo e juaja dhe kjo padyshim është një mirësi prej mirësive të Tij të shumta, për arsye se në thelb kjo tregon se bashkësia e myslimanëve është ndërgjegjësuar thellë për rëndësinë e normave islame në përgjithësi dhe ato të veshjes në veçanti. Allahu i Lartësuar thotë: “Me të vërtetë, madhërimi i riteve të Allahut vjen prej zemrave të devotshme.”

Në ditët e sotme sfidat për myslimanët sa vijnë dhe shtohen. Kjo tregon se Islami po përjeton një lëvizje dinamike të vazhdueshme që sa vjen dhe forcohet. Kjo ka ardhur si rezultat i asaj që përmenda pak më lart, pra si rezultat i një ndërgjegjësimi masiv të popullsisë në trojet shqiptare, në lidhje me rëndësinë e riteve dhe normave fetare në jetën e tyre të përditshme. Nga ana tjetër, ky dinamizëm ka zënë ngushtë pjesën tjetër të shoqërisë që nuk e sheh të arsyeshme ekspozimin e këtyre riteve dhe normave në jetën publike, sepse sipas tyre, edhe hapësira publike ka një natyrë laike që duhet respektuar. Dëshira e myslimanëve dhe në këtë rast e vajzave myslimane për të ekspozuar ritet dhe normat që ua dikton feja që kanë përfaqëuar, është përballur me një shqetësim në rritje të krahut tjetër të shoqërisë, që nuk ndan të njëjtin mendim dhe që në një formë apo tjetër, ka reflektuar refuzimin e vet përmes “demostrimeve të forcës”, që në terren është përkthyer në përjashtimin e këtyre vajzave nga shkollat apo hapësirat e tjera publike, të cilat padrejtësisht konsiderohen si hapësira laike. Në këtë mënyrë është e rëndësishme që mbrojtja e të drejtës së veshjes së shamisë islame, të jetë e organizuar, e mirëkonceptuar dhe në përputhje me situatën në terren. Kjo bën të domosdoshme që myslimanët të organizohen në grupe interesi të thjeshta, siç janë shoqatat dhe fondacionet sipas ligjeve në fuqi dhe më pas të krijojnë lobingje të mëdha me ndikim të madh në shoqëri. Kjo bën të mundur që myslimanët si palë interesi, të jenë prezentë në formulimin dhe diskutimin e ligjeve në arsim dhe në jetën publike, bën të mundur që të demonstrojnë prezencën e tyre përmes tubimeve, seminareve, simpoziumeve etj. të cilat sjellin ndërgjegjësimin e mëtejshëm të shoqërisë për të drejtën e mbajtjes së shamisë nga vajzat myslimane dhe bën të

mundur kundërshtimin profesional të arsyeve dhe justifikimeve, që ngrihen për ndalimin e veshjes së shamisë në ambientet publike etj.

Përsa i përket shamisë, ajo nuk është një simbol fetar, por një normë fetare, që ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me zgjedhjen individuale të vajzave myslimane për ta mbajtur, në zbatim të kërkesave të fesë që ajo i përket. Shamia në vetvete nuk ka asnjë mesazh, ajo thjesht është një mjet për të mbuluar ato pjesë të trupit që Islami i konsideron të turpshme, siç është rasti i flokëve tek gratë, por edhe rasti i pjesëve të tjera të trupit që duhen mbuluar, si tek burrat po ashtu edhe tek gratë. Sulmet kundër shamisë janë të kuptueshme. Nëse kthehemi pas në kohë, do të shohim se komunizmi e filloi “punën bindëse” për ideologjinë “përparimtare” nga shamia, për arsye se shamia ishte treguesi më i dukshëm i kapjes pas normave fetare tek familja në përgjithësi dhe tek gruaja në veçanti. Nëse nuk “do të çlirohej” gruaja nga idetë “prapanike”, atëherë ishte e pamundur për shoqërinë që të çlirohej prej tyre. Nga ky aspekt themi se përhapja e shamisë në ambientet publike është sinjali i parë i ndërgjegjësimit fetar të njerëzve dhe kthimit të tyre tek feja. Sigurisht kjo i shqetëson ata që deri dje mendonin se Islami kishte hyrë në një komë të pakthyeshme, por që pas rrëzimit të komunizmit u vërtetua e kundërta.

**- Tranzicioni që ka pësuar shoqëria shqiptare nga koha e Shpalljes së Pavarësisë së cunguar më 1912, a ka qenë në funksion të trendeve të rëndomta shoqërore të kohës, apo ka pasur projekte të hartuara nga të tjerët për ta ulur vlerën e shamisë (mbulesës), edhe sot, a ka tendenca të tilla dhe në funksion të kujt mund të jenë këto projekte për denigrimin e femrës shqiptare?**

Është fakt se kultura dhe civilizimet i lënë vendin njëra-tjetrës dhe si pasojë njëri civilizim që vjen demonstroi forcën mbi civilizimin që ikën, përmes shtrirjes në ide dhe territor. Këtij procesi i janë nënshtruar edhe trojet shqiptare pas largimit të Perandorisë Osmane, e kurorëzuar me Shpalljen e Pavarësisë. Kur flasim për civilizime, flasim padyshim për një mënyrë të kuptuarit të jetës dhe të jetuarit. Para dhe pas Shpalljes së Pavarësisë, trojet shqiptare kanë përjetuar një tkurrje të ndikimit të Islamit, që si rrjedhojë është reflektuar edhe tek mbajtja e shamisë apo e nikabit. Kjo ndodhi si pasojë e ndikimit të civilizimeve të tjera, të cilat nuk ndajnë me Islamin të njëjtin koncept për jetën dhe mënyrën e të jetuarit. Kur fola për komunizmin, fola pikërisht për këtë dhe padyshim që çdo sistem që vjen ka një agjendë të cilën përpiqet të vërë në jetë për të arritur ato objektiva në të cilat beson, ku bënte pjesë edhe denigrimi dhe shpërfillja e shamisë në jetën publike. Në epokën post-komuniste, feja në përgjithësi përjetoi një frymëmarrje dhe fitoi liri të shumta, të cilat i ishin privuar në sistemin që kaloi. Nga ky aspekt, ardhja e demokracisë që shoqërohet përgjithësisht nga fryma liberale dhe ajo laike, ka patur një ndikim pozitiv në liritë fetare, ku bën pjesë edhe mbajtja e shamisë, por herë pas here këto bindje të ndryshme nga ato islame përpiqen të imponojnë vetveten me demonstrime nga ato që përmendëm, por që përgjithësisht janë më shumë një fenomen shqiptar, sesa laik në vetvete, për arsye se të tilla reagime do t'i gjejmë shume të rralla në Perëndim.

**- Dihet nga historia e religjioneve se edhe**

**tek dy fetë e tjera që kanë poseduar libra qiellorë, ato Hebreje dhe Krishtere, mbulesa ka qenë obligative. Si erdhi ky ndryshim kaq i madh tek këto fe në nivel botëror?**

Revolucioni Francez bëri të mundur shkëputjen e kishës nga shteti, por efektet e këtij revolucioni kanë zgjatur në shekuj dhe janë transformuar herë pas here. Laicizmi dhe ateizmi në Perëndim, që sipas mendimit tim mori përmasa të jashtëzakonshme, erdhi si pasojë e pamundësisë së krishtërit për ofruar një alternativë të pranueshme për jetën, që t'i përshtatej ndryshimeve dhe nevojave të kohës. Kjo bëri që njerëzit të kërkonin alternativa të tjera, që përgjithësisht kishin për bazë një version njerëzor për mënyrën dhe normat e të jetuarit, pra sekularizmin dhe në disa shoqëri të tjera, edhe ateizmin. Kjo solli kundërshtimin e mbajtjes së shamisë si një normë kristiane, që sipas “ideve të reja” i përket të shkuarës dhe nuk ofron komoditetin që njerëzit kërkojnë sot. Si pasojë mbajtja e shamisë në perëndim është një fenomen i izoluar ose vihet re në zona me tradita konservatore. Tek jehuditë shamia vazhdon të jetë prezente për arsye se rrethanat historike kanë qenë të atilla për këtë komunitet sa që kapja pas identitetit fetar të ishte jetike për ekzistencën e tyre.

**- Duke u bazuar në atë që thatë më lart, cila mund të jetë rruga e kthimit të traditës së shamisë në trojet tona shqiptare?**

Së pari, është me rëndësi që shqiptarët të njihen me traditën dhe të kaluarën e tyre fetare. Për efekt të regjimit komunist që kanë kaluar shqiptarët shumë prej tipareve islame të historisë së tyre janë zbehur apo janë fshehur qëllimisht nga ky regjim, në mënyrë që shqiptarët ta humbasin lidhjen organike që kanë me të kaluarën e tyre islame dhe të hedhin sytë diku tjetër. Një pjesë shumë e rëndësishme e kësaj historie është shamia dhe këtë e vërtetojnë shumë dokumente filmike, fotografike apo publistike të kohës. Së dyti, duhet që shqiptarët të ndihen krenarë për të kaluarën e tyre islame, për arsye se përmes Islamit shqiptarët rrënjësorë edhe më thellë karakteristikat e tyre pozitive, siç ishte besa, sinqeriteti, burrëria, mëshira, toleranca etj., madje Islami ishte kodi i tyre shoqëror më i përkryer që sistemoi marrëdhëniet ndërnjerëzore në kohë të vështira, ku mungonte ligji dhe siguria. Shamia ka qenë gjithmonë prezente në familjet shqiptare, madje nuk mund të konceptohet dot një grua shqiptare me tradita pa patur veshur mbi kokën e saj një shami. Për këtë arsye, thirrjet për largimin e shamisë nga jeta shoqërore dhe publike e shqiptarëve, jo vetëm që nuk përshatën me memorien historike të tyre, por do të dështojnë për faktin, se nuk janë të natyrshme për ambientin shqiptar.

**- Shamia nga disa paragjykohet, kuptohet si mbyllje në vete, cënim i lirisë së femrës, barrë e rëndë mbi supe e deri tek mënyrë e imponuar e veshjes nga burrat. Cila është këshilla juaj për këtë?**

Këto janë vetëm pretendime, madje janë vetëm hamendësi, të cilat janë hedhur poshtë nga mjaft studime bashkëkohore. Në anketimet e bëra së fundmi me shumë gra të mbuluara në lidhje me këto hamendje, ka rezultuar se veshja e shamisë ka qenë me zgjedhje të lirë për një numër gati absolut të grave të mbuluara, se vetëm në pak raste të veçuara ka rezultuar që të jenë dhunuar për veshjen e shamisë etj. Nëse shamia do të kishte qenë një barrë e rëndë, nuk ka asnjë

kuptim që numri i vajzave të mbuluara të shtohet dita-ditës. Realiteti e hedh poshtë vetvetiu këtë pretendim. Në dy dekadat e fundit prezenca e grave që mbajnë shami është shtuar së tepërmi, madje prezenca e tyre është mjaft e dukshme në ambientet publike. Mendoj se kjo përhapje është edhe shkaku i këtyre hamendësive, që kanë për qëllim krijimin e një amullie në mendjet e atyre vajzave që mendojnë të veshin shaminë, por që falënderimi i takon Allahut, që efekti i tyre ka qenë minimal.

**- Me cilat mjete më së shumti sot luftohet shamia dhe cilat janë mënyrat më efikase për t'u mbrojtur nga këto sulme?**

Mjetet që përdoren sot janë mjaft të njohura, ku një rol të madh luan media që në mënyrë profesionale manipulon të vërtetat dhe nxit përhapjen e fushatave anti-shami në format nga më të ndryshmet. Po kështu edhe fobia që përhapet herë pas here nga elitat laike, ato politike apo kulturore, duke krijuar alarme të rreme për rrezikun e “islamizimit” të hapësirave publike dhe laike përmes shamisë. Disa nga mënyrat efikase për mbrojtjen e shamisë i përmenda në përgjigjen time për pyetjen e parë.

**- Ndalimin e bartjes së shamisë në shkolla publike si e shikoni ju, si një shtet mirë për shtimin e praktikuesve apo si tendencë për zhdukjen e tërësishme të kësaj pjese të fesë?**

Ndalimi i bartjes së shamisë në shkolla është një përpjekje për të minimizuar prezencën e shamisë në ambientet publike, me justifikimin se këto ambiente janë laike. Ky është një justifikim totalisht i pabazë, por që mund të diskutohet në një artikull të veçantë. Kjo fushatë është përgatitur si pasojë e asaj që thashë pak më lart, pra ndërgjegjësimit të shqiptarëve për t'iu kthyer vlerave të tyre fetare dhe demonstrimin e këtyre vlerave në mënyrë publike, si një e drejtë e tyre e pakontestueshme. Kjo ka shqetësuar qarqet të cilat me keqdashje e interpretojnë laicizmin si ateizëm dhe hapësirat publike, si hapësira laike. Siç e thashë më lart bëhet fjalë për një përpjekje për ta minimizuar dhe jo për ta zhdukur, për arsye se vetë kundështarët nuk e besojnë se mbajtja e shamisë mund të zhduket.

**- Cilat mund të jenë masat konkrete që mund t'i marrim ne si xhemat së bashku me hoxhallarët dhe institucionet fetare që të realizohet e drejta e bartjes së shamisë në shkollat publike në Kosovë edhe në Shqipëri pa u penguar?**

Hoxhallarët si prijës islamë duhet të jenë pararoja e çdo përpjekjeje që mund të bëhet në mbrojtje të shamisë, duke kërkuar ndihmën ligjore, mediatike dhe atë të këshillimit nga individë të caktuar në xhemat, që janë njohës të ligjeve, të medias dhe të të drejtave, në mënyrë që reagimet nëpër hytbe apo ligjëratat të shoqërohen me përpjekje ligjore për të dënuar sipas ligjit ata që përpiqen për ta cënuar këtë të drejtë, apo për të kundërshtuar çdo nismë ligjore, që synon largimin e vajzave me shami nga ambientet arsimore. Shpeshherë ana ligjore dhe ajo mediatike kanë munguar në përpjekjet që janë bërë për ta mbrojtur këtë të drejtë, gjë e cila duhet korriguar në të ardhmen.

**- Cili është mesazhi i juaj për ato vajza që hezitojnë të vendosin shaminë nga frika e përjashtimit nga shkolla?**

# Ramazani, muaji i triumfeve

Muaji i bekuar i Ramazanit mbart me vete krahas freskisë shpirtërore dhe ngjalljes së ndjenjave fetare, edhe aspiratat për një të ardhme më të lumtur, sepse e ndez në shpirtin e besimtarit shkëndinë e fitores dhe ngadhnjimit.

Kjo, ngase muaji i bekuar i Ramazanit është simbol i ngadhnjimit dhe fitores. Në vazhdim do të ndalemi në disa nga triumfet e muajit të Bekuar të Ramazanit:

## - TRIUMF I NJERIUT, DRITËS DHE TË VËRTETËS

Muaji i bekuar i Ramazanit, është muaji i triumfit të madh të njerëzimit mbi terrin e injorancës. Kjo, ngase në muajin e bekuar të Ramazanit filloi shpallja e Kur'anit i cili shpaloi një faqe të re në historinë e botës. Pas kësaj date, më nuk pati monopol padituria, injoranca dhe djallëzia, por njerëzit patën rast ta njohin të vërtetën dhe me dritën e Islamit ta largojnë terrin e mosbesimit.

Është e vërtetë se të gjithë njerëzit nuk iu bashkangjitën thirrjes Islame, por themi me plotë të drejtë se ky muaj, apo thënë më saktë kjo ngjarje paraqet triumf për njerëzimin në përgjithësi, sepse botërisht u luftua injoranca dhe besimet e gabuara, u sulmua terri me dritën e Islamit në përmasa globale, pra iu mundësua njeriut ta njohë të vërtetën dhe u krijuan kushte për identifikimin e saktë dhe preciz të së gabuarës.

## - TRIUMF MBI VETEN

Po, muaji i bekuar i Ramazanit është muaji i ngadhnjimit të njeriut mbi veten, gjegjësisht pasionet dhe kënaqësitë e tij trupore, shpirtërore mbi materialen.

Në muajin e Ramazanit muslimanët agjërojnë, pra heqin dorë nga ngrenia, pija, marrëdhëniet intime dhe fjalët e veprimet e liga.

Me këtë, njeriu ngadhnjen mbi veten, sepse e mëson të durojë pa i shijuar gjërat të cilat si zakonisht i lakmon. Shpirtit i jepet përparësi dhe nuk i lejohet trupit që të dirigjojë me njeriun duke i plotësuar e mos lënë pas dore nevojat e tij që i kërkon në çdo

moment.

Pra, me agjërim, njeriu e mund veten, dëshirat dhe lakmitë trupore dhe e mposht materialen me zbatimin e kërkesave të shpirtërore.

## -LUFTA E BEDRIT

Në muajin e bekuar të Ramazanit, gjegjësisht me 17 Ramazan të vitit të dytë të hixhretit, u zhvillua beteja e parë e madhe pas shpërnguljes së muslimanëve në Medine dhe formimit të shtetit Islam. Në këtë betejë, ku forcat idhujtare ishin me tepër në numër, muslimanët korrën fitore bindëse, fitore kjo e cila nuk pati vetëm karakter ushtarak, por parasëgjithash pati karakter ideologjik, sepse i gjithë opinioni i atëhershëm priste epilugun e fuqisë së re në arenën botërore, shtetit Islam të udhëhequr nga Muhamedi s.a.v.s. dhe forcave tradicionale idhujtare arabe të prira nga fiset idhujtare të Mekes. Në betejën e madhe të Bedrit, u mposhtën ushtarakisht idhujtarët nga njëra anë, dhe u mposht ideologjikisht kauza e kufrit-mosbesimit dhe forcat destruktive nga ana tjetër. Pas kësaj beteje, muslimanët u bënë faktor me rëndësi në arenën ndërkombëtare dhe krijuan realitet të reja brenda dhe jashtë regjionit arab.

Si atëherë, poashtu edhe sot dhe në çdo kohë, beteja e madhe e Bedrit do të jetë burim frymëzimi për punë dhe veprimtari aktive në prezentimin e kauzës Islame në botë, do të jetë gjenerator i dëshirës dhe ambicjeve për fitore dhe suksese në fusha të ndryshme të jetës, ashtu si që fituan muslimanët në luftën e Bedrit. Thënë shkurt, lufta e madhe e Bedrit, do të ushqejë shpirt optimist bashkëkohor musliman me plane dhe strategji të qartë për një të ardhme më të lumtur të bijve të këtij umeti.

## -ÇLIRIMI I MEKES

Fitorja ideore dhe imponimi i vetes në arenën ndërkombëtare, nuk u manifestua vetëm në luftën e madhe të Bedrit, por kjo u demonstrua edhe në çlirimin e Mekes. Pra, në muajin e bekuar të Ramazanit, muslimanët

në krye me Muhamedin s.a.v.s. u kthyen në Meke çlirimtar, pasi u dhunuan një kohë të gjatë në të nga banorët e saj idhujtar, dhe u larguan me urdhërin e Allahut xh.sh. që në Medine ta ngritin shtetin e parë Islam.

Çlirimi i Mekes, nuk ka thjesht rëndësi teritoriale, apo si që thuhet me gjuhën e luftës fitim të teritoreve, por para së gjithash pati rëndësi ideore. Kjo, ngase Mekeja paraqiste atëbotë bastionin e fundit dhe më të fortë të idhujtarisë klasike arabe, por kur kihet parasysh e kaluara e saj historike dhe pozita e saj te popujt e rajonit dhe më gjërë si vatër e të dërguarve të Zotit dhe krijimit të kulturave e civilizimeve, ndodhitë në të i tejkalonin kufijt nacional dhe regional.

Pra, me këtë rast, u grushtua bastioni i fundit i idhujtarisë, u mposht doktrina

## Muaji i Ramazanit në të cilin zbriti Kurani

idhujtare dhe u prenë pejtë e mbështetjes së mosbesimit. Çlirimi i Mekes, rrënim i idhujve dhe pastrimi i Qabes, jo vetëm që ishte triumf për ushtrinë muslimane në kuptim të brendshëm, por paraqiti kthesë të madhe edhe në pozitën e tyre në arenën botërore, sepse tash më ata ishin të zotët e vërtetë e tempullit që ishte simbol fetar, kulturor, civilizues e historik i mbarë botës.

Çlirimi i Mekes, i ushqen ndjenjat e muslimanëve dhe aspiratat e tyre që të vazhdojnë në thirrjen e tyre në të vërtetat Islame, sepse ashtu sikur që u rrënuat gënjshtra klasike idhujtare atëbotë, ashtu do të mposhten edhe gënjshhtar e të gjitha ngjyrave dhe kohërave para të vërtetës Islame.

## -LUFTA E TEBUKUT

Në muajin Ramazan të vitit të nëntë të hixhretit, ushtria muslimane u gjend përballë një superfuqie të atëhershme, pra

ushtrisë Romake, në Tebuk. Jo vetëm që ushtria muslimane triumfoi në këtë betejë, por triumf paraqet edhe fakti se me t'u dhënë urdhëri për luftë me romakët, shokët e të dërguarit të Allahut vrapuan se kush me i pari do t'i përgjigjet thirrjes. Nuk luajti rol ajo se bëhej fjalë për një superfuqi të asaj kohe, sepse muslimanët ishin të bindur në vetvete dhe në fenë të cilës i takonin, ishin të bindur në kauzën të cilën e mbronin, dhe për realizimin e këtyre synimeve, nuk kishte fuqi që mund t'i ndalte.

Kjo betejë duhet të flase shumë për muslimanët, gjegjësisht t'ua bëjë me dije se të parët e tyre u ballafaquan me fuqinë botërore të atëhershme, romakët, dhe dolën ngadhnjimar. Muslimanët, nuk duhet të nënshtrohen para tjerëve, por në të njejtën kohë nuk bënë edhe të qëndrojnë në fund të varganit të jetës dhe përparimit, e pastaj të presin keramete pa dhënë mund. Rëndësia e kësaj beteje qëndron në faktin se muslimanët u ballafaquan me një faktor të jashtëm dhe me ndikim më politikën e atëhershme botërore dhe pas kësaj ngjarje, emri i muslimanëve u dëgjua në anë të ndryshme të botës dhe u pa se janë fuqi serioze e cila dalëngadalë por sigurt e zen vendin e vet të merituar në skenën botërore.

## -ÇLIRIMI I SPANJËS

Në vitin e 92 të hixhretit, muajin e bekuar të Ramazanit, u përgatit ushtria Islame në krye me Tarik ibn Zijadin për çlirimin e Spanjës-Andaluzisë. Kjo ushtri e cila nisi në muajin e Ramazanit, më vonë arriti ta çlirojë Spanjën dhe aty të ndërtojë muslimanët civilizim madhështor i cili e mahniti botën, e në veçanti Europën, e cila atëbotë ishte krejt në baltë dhe injorancë, dhe e habitur shiqonte se çka ndërtojë muslimanët në këtë troll të kontinentit të tyre. Po ashtu, muslimanët aty e shuajtën dhunën që ushtrohej mbi njerëzit e dobët dhe të pa fajshëm nga tiranët e ndryshëm, gjë që flet se misioni i muslimanëve në Spanjë ka qenë human dhe paqësor.

## Përgatiti Sulejman Rustemi

Vajzat që dëshirojnë të vendosin shaminë duhet ta kenë parasysh se me këtë veprim ato po zbatojnë një normë islame, e cila kënaq Allahun e Lartësuar dhe që në asnjë moment nuk e lë në baltë robin e Vet, i cili përpiqet ta kënaqë. Nuk duhet të harrojmë se në realitetin shqiptar post-komunist të viteve 90' ishte e paimagjinueshme që një vajzë të mbulohej, por me shumë këmbëngulje dhe besim, këto vajza dhanë shembullin më të mirë të dëshirës për ndryshim. Rrugët e mbushura me gra të mbuluara janë padyshim fryt i këmbënguljes së këtyre vajzave që sot janë nëna dhe po edukojnë një brez tjetër edhe më të fuqishëm dhe këmbëngulës se më parë. Nëse vërtetë ato kanë vendosur të ndryshojnë dhe të kalojnë në një etapë tjetër të jetës së tyre tashmë të bazuar mbi normat e Islamit, të jenë të bindura se asgjë nuk mund t'i ndalojë dhe se kurrë nuk do të jenë vetëm në luftën e tyre. Prandaj nuk kanë asnjë arsye për luhatje dhe asnjë arsye për një kthim prapa.

**- Cili është obligimi ynë si shoqëri islame karshi vajzave që përjashtohen nga shkolla për shkak të mbulesës?**

Obligimi ynë është që t'i qëndrojmë pranë me të gjitha format e mundshme dhe ligjore,

dhe mbi të gjitha duhet që njerëzve të thjeshtë t'u përcillet mesazhi, se muslimanët janë njerëz që e duan dijen dhe se askush nuk mund t'i privojë ata prej saj. Rrethi shoqëror dhe familjet e shëndosha që kanë parime islame, mund të luajnë një rol të pazëvendësueshëm në mbrojtjen e këtyre vajzave. Këtu i referohem kundërshtimit që i bënë vendimit për të larguar një vajzë me shami disa nxënëse në një shkollë në Mitrovicë, gjë e cila tregoi se shqiptarët ende janë një shoqëri që duan fenë dhe e sakrifikojnë për të. Nga ana tjetër ka plot njerëz të mendjes, muslimanë dhe jo muslimanë, që kur vjen puna për të drejtat e njeriut për t'u arsimuar dalin në mbrojtje të këtyre vajzave dhe i dënojnë rëndë vendimet për përjashtimin e tyre. Pra me një fjalë, ne dhe e gjithë shoqëria shqiptare duhet të bëhemi pjesë e zgjidhjes së kësaj problematike, gjë që kërkon prej nesh një fushatë të gjërë sensibilizimi në media, forume, takime etj. në mënyrë që çështja e shamisë në shkolla të kthehet në një çështje e të gjithë shoqërisë shqiptare.

**- Mund të na thoni shkurtimisht ndonjë sakrificë që muslimanet e hershme kanë bërë për shaminë?**

Historia islame është e mbushur me qëndrime në mbrojtje të shamisë. Kujtojmë këtu ngjarjen e një sahabiu në treg, ku çifutët lidhën shaminë e një gruaje që po qëndronte ulur me këpucët e saj dhe kur u ngrit shamia dhe xhybja që mbulonte trupin e saj ranë në tokë dhe gruaja u zbulua. Sahabu që pa këtë ngjarje u prek së tepërmi dhe në zemërim e sipër vrau çifutin që bëri një veprim të tillë dhe më pas u vra nga çifutët e tjerë. Kujtojmë gjithashtu qëndrimin e grave të Shkodrës, të cilat pas urdhërit të mbretit Zog për të hequr shaminë, refuzuan të dilnin në rrugë pa shami dhe lëviznin duke shfrytëzuar oborret e fqinjve për të kaluar nga një vend në tjetrin, për të plotësuar nevojat ekonomike dhe sociale të ditës. Shembuj të tillë nga jeta e muslimanëve në përgjithësi dhe të shqiptarëve në veçanti janë të shumtë.

**- Për fund, një këshillë nga ju për iniciativën "Në Mbrojtje të Shamisë". Allahu jua shpërbleftë me të mirat e Tij, me Xhenet në këtë dunja edhe me Firdeus në Ahiret!**

Këshilla ime është që nisma juaj të jetë e sinqertë për të kënaqur Allahun e Lartësuar në mënyrë që ajo të ketë bereqet dhe të japë rezultat e pritura. Nga ana tjetër do t'ju këshilloja që të këmbëngulnit në objektivin

tuaj dhe të mos stepeshit në asnjë moment, derisa të shihnit qëllimet tuaj të bëra realitet në terrenin shqiptar. Kjo padyshim është shenjë e dashurisë tuaj për fenë dhe një krenari për të gjithë kombin shqiptar, që ka nxjerrë nga gjiri i tij njerëz që u dreg zemra për fenë madhështore të Islamit dhe që do të vazhdojnë të mbrojnë pa kursim traditën e bukur islame tek shqiptarët. Allahu e vendostë në peshorën e veprave të mira përpjekjen tuaj fisnike.

**Hoxhë i nderuar edhe njëherë ju falënderojmë për këshillat dhe realitetet që nxjerrët para nesh, duke treguar edhe njëherë që shamia dhe e drejta e saj janë pjesë e identitetit tonë si musliman me fe, si shqiptarë me kombësi dhe si njerëz si lloj i krijesave. Lusim Allahun që ritet e Tij të madhërohen çdoherë në zemrat tona e të dalim para Allahut duke qenë Ai i kënaqur me ne.**

Falënderimi me lavdërim i takon vetëm Allahut, ndërsa paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të Dërguarin e Tij [Muhamedin salAllahu alejhi ue salam], mbi familjen e tij, shokët dhe mbi të gjithë ata që pasojnë rrugën e tij deri në ditën e Gjykimit.

Tefsir/

**O ju që keni besuar, ju është bërë detyrë agjërimiti ashtu siç ishte për ata që ishin para jush në mënyrë që të ruheni (prej zjarrit)**

# Ramazani muaji i shenjtë i Agjërimit

**Disa ajete të përzgjedhura mbi agjërimitin e muajit të shenjtë të Ramazanit**

Allahu i madhëruar thotë në Kuran:

**“O ju që keni besuar, ju është bërë detyrë agjërimiti ashtu siç ishte për ata që ishin para jush në mënyrë që të ruheni (prej zjarrit)”** Suretu El-Bekare: 183.

**“Muaji i Ramazanit në të cilin zbriti Kurani udhëzim për njerëzit, sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues i saj nga rruga e shtrembër, këdo që e gjen ky muaj le ta agjërojë atë”** Suretu El-Bekare: 185.

Këto ajete i kanë zbritur profetit alejhi selam në vitin e dytë hixhretit dhe me to është bërë detyrë agjërimiti i ramazanit ndërkohë që para tij kishte zbritur urdhri për namaz në natën e israsë dhe miraxhit tre vite para hixhretit.

Ajeti i parë: **“O ju që keni besuar, ju është bërë detyrë agjërimiti ashtu siç ishte për ata që ishin para jush në mënyrë që të ruheni (prej zjarrit)”** Suretu El-Bekare: 183.

Ky ajet përmban:

**1- Allahu u thërrret besimtarëve.**

Allahu i madhëruar u thërrret besimtarëve në emër të besimit, ky emër i cili i veçon nga të tjerët dhe i kujton ata me deklaratën e shhadetit që kanë bërë para tij. Pastaj kjo lloj thirrje nuk vjen në këtë mënyrë veçse për një punë të dobishme ose për tu larguar nga një e keqe siç thotë Abdullah ibn Mesudi radiallahu anhu: **“Kur të dëgjosh thirrjen [O ju që keni besuar] dëgjoje me vëmendje se është ose hajër që po urdhërohet për të ose sherr për tu larguar prej tij”**.

Thirrja në emër të besimit përjashton ata që nuk janë në besim sepse atyre u kërkohet si fillimi islami i cili është kushti i pranimit të punëve të tyre.

Nga kjo thirrje përjashtohet gjithashtu edhe ai që nuk e kupton atë si i vogli dhe njeriu me të meta mendore dhe po ashtu edhe ai që nuk ka mundësi ta zbatojë thirrjen si: i sëmuri, plaku i moshuar, gratë shtatzëna dhe gjdhënëset.

**2- Thirrja është për agjërim.**

Agjërimi është një lloj adhurim ku njeriu heq dorë përkohësisht nga disa prej qejfeve të kësaj bote për hire të Allahut e madhëruar për të fituar kënaqësinë e tij dhe për ta depozituar atë për në ditën kur njerëzit dalin para Allahut për llogari. Ky lloj adhurimi është plotësim i rrethit të nënshtrimit të plotë para Allahut të madhëruar që bëhet me zemër siç është besimi, me gojë siç është shhadeti dhe përmendja e Allahut, me trup siç është namazi dhe haxhi, me pasuri siç është zeqati, me largim nga qejfet e kësaj bote siç është agjërimi dhe në fund edhe me flijim të shpirtit nëse lipset siç bëri Ibrahim alejhi selam me të birin e tij.

Kjo gjë na kujton me ajetin ku Allahu i madhëruar i emërton pasuesit e kësaj feje myslimanë që do të thotë i dorëzuar i Allahut siç thotë Allahu në kuran: **“O ju që keni besuar, përkuluni, bini në sexhde, adhurojeni Zotin tuaj dhe bëni vepra të mira që të shpëtoni”** Përpuni me vërtetësi në rrugën e Allahut se ai ju ka zgjedhur dhe nuk ju ka bërë vështirësi në fe. Ndiqni fenë e babet tuaj Ibrahimit! Allahu ju ka emërtuar myslimanë më përpara (në librat e hershëm) dhe tani (në Kuran).” Suretu El-Haxh: 77-78.

**3- Agjërimi, adhurim që është kërkuar edhe prej popujve të tjerë.**

Njësimi i Allahut është e përbashkëta e profetëve siç thotë Allahu i madhëruar në Kuran: **“Nuk kemi dërguar ndonjë profet para teje veçse i kemi shpallur se nuk ka të adhuruar tjetër veç meje pra më adhuroni!”**

Dhe ata përveç njësimi kanë pasur edhe të përbashkëta të tjera në disa punë si namazi

dhe agjërimi. Agjërimi është përmendur në këtë ajet kurse namazi është përmendur në historinë e Musës alejhi selam kur i Allahu i thotë atij: **“Unë të kam zgjedhur ty dhe dëgjo me vëmendje se çdo të shpallim \* Unë jam Allahu që nuk ka të adhuruar tjetër veç meje dhe kryeje namazin për përkujtimin tim”** suratu Taha: 13-14.

Mirëpo këto të përbashkëta që kanë lidhje me punët edhe mund të ndryshojnë në mënyrën, kohën, numrin dhe në lehtësinë apo vështirësinë e kryerjes. Prandaj dhe profeti alejhi selam thotë: **“Profetët janë vëllezër nga babai. Feja e tyre është një dhe nënat janë të ndryshme”**.

Fjala e tij [nënat janë të ndryshme] do të thotë: rregullat e adhurimit -jo të besimit-mund të ndryshojnë siç u tha më lart në mënyrë, kohë, numër, vështirësi etj. dhe pikërisht këtë gjë ka dashur të sqarojë Allahu në kuran kur ka thënë: **“Secilit prej tyre (profetëve) i kemi bërë ligje dhe rregulla (të veçanta)”**.

Ngjasimi në agjërim është siç thonë shumë komentues të kuranit agjërimi i tre ditëve në çdo muaj i cili ka qenë detyrë që nga Ademi e deri te profeti ynë, gjë e cila u anulua me vonë kur u bë detyrë agjërimi i ramazanit por që vazhdon të jetë e pëlqyeshme dhe jo detyrë.

Është thënë gjithashtu se ngjasimi në agjërim është në vetë ramazanin. Es-Sudi (një prej komentuesve të kuranit i vdekur 127 H) thotë: **“Ju vështirësua të krishterëve agjërimi i ramazanit sepse binte edhe në dimër edhe në verë dhe kur ndodhi kjo gjë ranë dakord ta fiksojnë agjërimin e tyre në stinën mes dimrit dhe verës dhe vendosën të shtojnë edhe njëzet ditë si shlyerje për ndryshimin”** diçka të përafërt me këtë që u tha është treguar edhe nga Shabiu.

Ndërsa prej ndryshimeve në agjërim është syfyri siç thotë profeti alejhi selam: **“Nryshimi mes agjërimit tonë dhe agjërimit të ehli kitabit është syfyri”**.

Pra agjërimi i tyre ishte pa syfyr nga iftari në iftar gjë e cila ka qenë edhe tek ne në fillim të islamit por që u anulua dhe u bë nga agimi në perëndim ose nga syfyri në iftar.

Po ashtu edhe iftari nuk ka qenë në të njëjtën kohë me ne siç thotë profeti alejhi selam: **“Feja do vazhdojë të jetë e dukshme (pjesë e jetës së njerëzve) derisa njerëzit e shpejtojnë iftarin (ta çelin menjëherë pas perëndimit) sepse çifutët dhe të krishterët e vonojnë”**.

Sot çifutët dhe të krishterët agjërojnë ndaj disa lloje ushqimesh dhe jo ndalim të plotë nga ngrënia dhe pirja. A është edhe kjo prej ndryshimeve që i ka bërë Allahu në rregulla apo prej ndryshimeve të tyre, këtë vetëm Allahu e di më së miri.

4- Nga agjërimi rrjedh devotshmëria.

Agjërimi është nënshtrim i shpirtit duke e frenuar atë nga disa dëshira të tij dhe kjo bën që njeriu ta ketë nën kontroll shpirtin e tij dhe ska dyshim se njeriu është i prirur për të rendur pas qejfeve të kësaj bote siç thotë Allahu në kuran:

**“Është zbuluar për njerëzit rendja pas qejfeve: gratë, fëmijët, depot e floririt dhe të argjendit, kuajt e shaluar, bagëtitë dhe të mbjellat. Ato janë plaçkë e kësaj bote dhe të Allahu është kthimi i mirë”**

Dhe rendja e pa kontrolluar me rregullat Allahut të le bosh në ahiret siç thotë Allahu në kuran: **“Dijeni se jeta e dynjasë është lojë, argëtim, mburrje konkurrim në pasuri dhe fëmijë si puna e shiut i cili i gëzon bujqtë me bimët që dalin pas tij pastaj thahen, zverdhën dhe copëtohen dhe në ahiret ka**

**dënim të ashpër dhe falje prej Allahut. Nuk është jeta e dynjasë veçse plaçke e të mashtruarit”**

Atëherë agjëruesi duke futur nën kontroll qejfet e dëshirat e tij arrin në dy gjëra: shton vullnetin për punë të mira të cilat kanë vlerë të Allahu dhe mposht dëshirën për punë të liga dhe kjo është kuptimi i devotshmërisë që ka dashur Allahu sepse devotshmëri do të thotë: të bësh mes teje dhe asaj pune që zëmëron Allahun një mburojë dhe kjo nuk mund të ndodhe veçse me kryerjen e detyrave dhe largimin nga të ndaluarat siç thoshte Umr bin Abdulaziz: **“Devotshmëria është të lësh atë që ka ndaluar Allahu dhe të bësh atë që të ka urdhëruar Allahu”**.

Ajeti i dytë: **“Muaji i Ramazanit në të cilin zbriti Kurani udhëzim për njerëzit, sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues i saj nga rruga e shtrembër, këdo që e gjen ky muaj le ta agjërojë atë”**. Suretu El-Bakara: 185.

Ky ajet përmban:

**1- Ramazani muaj prej muajve hënor sipas ndarjes së kohës në librin e Allahut.**

Muaji i ramazanit është i vetëm muaj hënor i përmendur në kuran dhe është një prej 12 muajve që përbëjnë 12 cikle hënore (mbushje-zbrazje) sipas të cilave ndahet koha të Allahu.

Allahu thotë në kuran: **“Numri i muajve të Allahu është 12 muaj, në librin e Allahut, atë ditë që ka krijuar qiellin dhe tokën. Katër prej tyre janë të shenjtë. Kjo është feja e drejtë pra mos i bëni në to zullum vetës tuaj”**. (Surat Et-Teube: 36).

Muajt hënorë janë: Muharrem, Safar, Rabi-ul-Euuel, Rabi-ul-Akhir, Xhumade El-Ula, Xhumade el-Ukhra, Rexhep, Shaban, Ramazan, Sheval, Dhul-Kade, Dhul-Hixhxhe.

Llogaritja e këtyre muajve është me hënën ku çdo muaj ka 29 ose 30 ditë një cikël i plotë hënor mbushje-zbrazje. Profeti alejhi selam në një hadith të transmetuar nga ibn Umri thotë: **“Ne jemi ymet analfabet nuk lexojmë dhe as llogarisim. Muaji është: kësbtu, kësbtu dhe kësbtu”** duke bërë me gishta një herë 29 dhe një herë 30. E transmeton Buhariu.

Hyrja në Ramazan bëhet si në çdo muaj tjetër me shikimin e hënës siç thotë profeti alejhi selam në hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejra radiallahu anhu: **“Agjëroni kur ta shihni hënën dhe çeleni kur ta shihni atë! Nëse retë ju pengojnë atëherë plotësojeni Shabanin 30 ditë”** e transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Ky hadith përmban dy rregulla në lidhje me hyrjen në Ramazan:

a- Agjërimi duhet të jetë me shikimin e hënës me sy dhe po ashtu edhe çelja se profeti alejhi selam thotë: [Agjëroni kur ta shihni hënën dhe çeleni kur ta shihni atë!]. Kjo tregon se përjashtohet mënyra tjetër që nuk bazohet në shikimin e saj por në llogaritje astronomike. Sheikhu islam Ibn Tejmije thotë: Nuk njihet ndonjë kundërshtim i hershëm në këtë çështje veçse pas 100 vjeçarit të tretë të këtij ymeti.

b- Agjërimi i myslimanëve duhet të jetë i përbashkët se profeti alejhi selam u drejtohet myslimanëve në shumës [Agjëroni]. Kjo tregon se përjashtohet mendimet që thonë se çdo vend duhet të ecë me shikimin e tij. Sheikhu islam ibn Tejmije thotë: rregulli i përfutur nga ky hadith është se kujt i mbërrin lajmi duhet të agjërojë.

Mund të pyes dikush se pse në hadithin e Kurebit, Ibn Abasi radiallahu anhu nuk punoi me shikimin e Muavijes radiallahu anhu?

Le të përmendim të përmendim si fillim hadithin e plotë për të parë ku qëndron problemi pastaj ti japim përgjigje pyetjes:

Kurejbi një tabiin, e kishte dërguar atë një

sahabie që quhet Ummul-Fadl bint El-Harith për te Muavija në Sham para Ramazanit. Ai thotë: **“Mbërrita në Sham dhe pasi kreu nevojat e mija më zuri atje Ramazani dhe e pashë hënën natën e xhuma. Kur mbërrita në Medine në fundin e muajit, Abdullah bin Abasi më pyeti për udhëtimin dhe në fund përmendi hënën dhe më tha: e patë hënën? I thashë: e pamë natën e xhuma. Ai më tha: ti vetë e pe? I thashë: po, dhe e panë edhe të tjerët dhe agjëruan dhe agjëroi edhe Muavija. Ai më tha: Por ne e kemi parë natën e shtune dhe do të vazhdojmë të agjërojmë derisa të plotësojmë 30 ditë ose të shohim hënën. I thashë: nuk të mjafton shikimi i Muavijës dhe agjërimi i tij? Ai më tha: jo, se kështu na ka urdhëruar i dërguari i Allahut.”** E transmeton Muslimi.

Sheikh El-Albani -Allahu e mëshiroftë-thotë në lidhje me përgjigjen e pyetjes tonë thotë: Hadithi i Ibn Abasit ka ardhur për atë njeri që e ka nis Ramazanin me shikimin e tij dhe gjatë ramazanit lajmërohet se në një vend tjetër e kanë parë hënën një ditë përpara. Atëherë në këtë rast ai vazhdon të agjëroj me banorët e vendit të tij derisa të plotësojnë muajin 30 ditë ose derisa ta shohin hënën përpara plotësimit të tij. Kështu mbetet hadithi i Ebu Hurejres në përgjithsimin e tij duke përfshirë çdo njeri që i mbërrin lajmi se hëna është parë në një vend. Kjo gjë është sot është e lehtë por kërkon interesimin e vendeve islame që të bëhet realitet.

Tani, derisa shtetet islame të bien dakord për këtë gjë (që të mjaftohen me shikimin e njerit vend) atëherë e shoh që çdo popull të agjërojë me shtetin e tij dhe të mos ndahet.

Fakti që njerëzit e një vendi nuk duhet të ndahen në agjërim dhe në çelje është edhe një hadith tjetër i transmetuar nga Ebu Hurejra radiallahu anhu se profeti alejhi selam ka thënë: **“Agjërimi është atë ditë kur agjërojnë njerëzit, çelja është atë ditë kur çelin njerëzit dhe kurbanit është atë ditë kur bëjnë kurban njerëzit”** e transmeton Termidhiu dhe e saktëson sheikh Albani.

Termidhiu thotë në kuptimin e këtij hadithi: Disa dijetarë e kanë shpjeguar këtë hadith dhe kanë thënë: kuptimi i tij është se agjërimi dhe çelja janë me bashkësinë e njerëzve.

Po ashtu edhe Aisha radiallahu anha e këshillon një tabiin që quhet Mesruk për të njëjtën gjë. Mesruku thotë: **“Shkova te Aisha ditën e Arafatit (duke qenë pa agjërim) dhe Aisha radiallahu anha thotë: Jepni Mesrukut Seuik (një lloj ushqimi i lëngshëm) dhe bëjani të ëmbël! Mesruku i thotë asaj: Nuk më pengoi gjë të agjëroj sot veçse pata frikë se është dita e kurbanit. Aisha i thotë: Kurban është atë ditë kur njerëzit bëjnë kurban dhe çelje është atë ditë kur njerëzit çelin.”** E transmeton Behkaiu dhe e saktëson sheikh Albani.

Një tjetër çështje që të çon në të njëjtin përfundim: Në çeljen e Ramazanit kur kemi vetëm një dëshmitar që ka parë hënën dhe nuk plotësohen dy atëherë njerëzit do agjërojnë që të plotësojnë muajin 30 ditë kurse shikuesi i hënës çfarë duhet të bëjë, ta çelë vetëm apo të agjërojë me njerëzit?

Përgjigja nga sheikhu islam Ibn Tejmije: Ai që e ka parë vetëm hënën nuk duhet ta çelë Ramazanin në publik dhe për këtë kanë rënë dakord të gjithë dijetarët. Por, a i lejohet ta çelë fshehurazi? Ka dy mendime mes dijetarëve, më i sakti prej tyre është se nuk duhet ta çelë fshehurazi.

Pra, të agjërojë atë ditë me njerëzit që të bëjë bajram me ta ditën tjetër.

*Nga hoxhë dr. Abdullah Nabolli*

# Ramazani muaji i pendimit



Pendimi është profesioni i jetës, është fillimi i robit dhe mbarimi i tij, madje është qëndresa e parë e adhurimit, mesi dhe fundi i saj.

Nevoja jonë për pendim është tejet e madhe, madje domosdoshmëria jonë ndaj saj është urgjente, sepse ne gabojmë shumë dhe jemi të pakujdesshëm në të drejtat e Allahut natën dhe ditën; kështu ne kemi nevojë të skalimisim zemrat, t'i pastrojmë ato nga ndryshku i mëkateve dhe gjynaheve.

O ju agjërues! Pendimi është: lënia e gjynahut duke e ditur se ajo është gjë e shpifur, duke të ardhur keq për veprimin e saj, të këmbëngulësh se nuk do të kthehesh tek ajo nëse të jepet mundësia, si dhe të kompensosh ato punë që mund të kompensosh, të kujdesesh për obligimet që ke humbur duke qenë i sinqertë për Allahun, të shpresosh shpërblimin e Tij, t'i frikësohesh dënimit e të gjithën këtë ta bësh para se të vijë shpirti në grykën e fytit, apo të lindë Dielli nga Perëndimi, sepse në këtë rast ajo nuk është e pranuar e nuk quhet më pendim, përderisa nuk është bërë në kohën e duhur.

Të nderuar agjërues! Allahu i Lartësuar me begatinë dhe bujarinë e Tij e ka hapur derën e pendimit, madje Ai ka urdhëruar për të dhe ka premtuar se do ta pranojë sado të mëdha të jenë gjynahet. Allahu thotë në Kuranin famëlartë: "Kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtrojeni Atij, para se t'ju vijë dënimi, sepse atëherë nuk do të mund t'ju

ndihmojë kush". Zumer, 54.

Po ashtu thotë: "Ai e pranon pendimin e robërve të Vet, i fal gjynahet dhe i di të gjitha çfarë punoni ju". Shura, 25.

Po ashtu Ai ka thënë në lidhje me ata të cilët hapën hendeqe që të digjinin besimtarët në mënyrë që t'i kthenin nga besimi në Allahun:

"Pa dyshim, ata që i përndjekin besimtarët dhe besimtarët e nuk pendohen, i pret dënimi i Xhehenimit dhe dënimi me djegie". Buruxhë, 10.

Imam Hasen el Basriu, në lidhje me këtë, ka thënë: "Shikoni në këtë bamirësi bujari, ata vranë miqtë e Allahut dhe Allahu sërish i fton të pendohen".

Madje Allahu i lartësuar ka tërhequr vërejtjen nga humbja e shpresës ndaj mëshirës dhe faljes së Allahut:

"Thuaj: "O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti". Zumer, 53.

Sahabi i nderuar Ibnu Abasi ka thënë: "E kush mundet të humb shpresën pas kësaj, padyshim që ai ka mohuar librin e Allahut".

Pendimi vëllëzër dhe ju o motra është shkak për fitore, është rrugë e lumturisë; pendimi të eliminon mëkatet e mëparshme, madje Allahu për shkak të tij i kthen gjynahet në të mira e sevape.

Pendimi është nga adhurimet më të dashura te Allahu i lartësuar, madje Ai gëzohet për pendimin e robërve të Tij. Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: "Allahu gëzohet për pendimin e robit të Tij, më shumë se dikush i cili pushon në një vend të shkretë, e që bashkë me të ka kafshën tek e cila gjendet ushqimi dhe uji i tij. Ai mbësht kokën dhe fle për një kohë dhe në momentin që zgjohet gjën se kafsha e tij është larguar, ndërkohë që atë e ka zënë një etje e madhe. Pasi i humb shpresat se mund ta gjejë, kthehet në vendin e tij dhe pushon e fle (duke pritë vdekjen) dhe kur zgjohet e ngre kokën, gjën se kafsha e tij ishte kthyer

përsëri tek ai". Buhari dhe Muslimi.

Allahu i lartësuar këtë gëzim nuk e ka shprehur në asnjë adhurim tjetër me të cilin e adhurojnë robërit e Tij, dhe padyshim që një gjë e tillë lë gjurmë të mëdha në shpirtin e atij që dëshiron të pendohet.

Ndaj o rob i Allahut! Ti që i ke bërë padrejtësi vetes! Që e ke turpëruar veten dhe e ke tepruar në mëkate, sado të mëdha, të poshtra dhe të turpshme t'i kesh mëkatet, t'i përsëri ke para teje një portë të hapur. Hyr në të e mos nguro. Të jesh i sigurt se do të kënaqesh pasi të kesh hyrë, sepse do të jesh vërtet tjetër njeri.

Të kam rixha, nisu kësaj rruge e trokit në këtë derë, përgjigju thirrjes së Zotit tënd, çliroje veten nga robëria e mëkatit e mos qëndro më në këtë gjendje, sepse nëse vdes kështu, atëherë nuk ke më shanse për t'u penduar.

Mos hezito të pendohesh, mos nguro të kthehesh tek Allahu, sepse Ai dorën e Tij të shtrirë e mban për të pranuar ty dhe mua, o rob i Allahut. Mos vallë nguron të pendohesh se mëkati yt është shumë i madh, apo se gabimi yt është një ves i ulët dhe i turpshëm, apo mos vallë ke frikë se a do të të pranojnë njerëzit?

O rob i Allahut! Por ti bëje hapin e duhur, pendohu tek Allahu sinqerisht e Ai më pas do t'i bëjë njerëzit që të duan dhe të pranojnë, madje që të kuptojnë se tashmë ti ke hequr dorë nga mëkati e ke hapur një fletë të re në ditarin e jetës tënde.

Shfrytëzojë këtë shans që të ka ardhur o Agjërues, ti tashmë je në një adhurim të madh, dhe mundësia për të shkuar drejt rrugës së pendimit është po kaq e madhe.

**Pendimi që të jetë në standardin e duhur patjetër duhet t'i plotësojë pesë kushte themeltare:**

**E para:** Duhet patjetër në momentin që ke vendosur të pendohesh, të heqësh dorë menjëherë nga gjynahu apo vesi i ulët ku ke rënë. Duhet patjetër që konsumuesi i alkoolit i cili do të pendohet, ta ndërpresë menjëherë pijen e alkoolit, imorali ta braktisë në

moment imoralitetin. Sepse thënia: "O Zot më fal" duke qenë se ende je duke mëkatuar, nuk mund të quhet pendim.

**E dyta:** Kushti i dytë është vendosmëria e personit për të mos u kthyer më kurrë në këtë mëkat prej të cilit ai po pendohet. Po nëse pas kësaj vendosmërie njeriu bie sërish në këtë mëkat, ai duhet përsëri të pendohet sepse ky konsiderohet mëkat i ri i cili nuk ka lidhje me mëkatin e parë prej të cilit njeriu është penduar.

**E treta:** Mëkatari duhet të ndiej keqardhje në vetveten e tij për mëkatet që ka bërë dhe kjo është shumë domethënëse, sepse Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: "Keqardhja për mëkatin është pendim". Ibnu Maxhah dhe Hakim. Shejh Albani e ka konsideruar si hadith të saktë.

**E katërta:** Nëse mëkati dhe gjynahu ka të bëjë me të drejtën e bijve të Ademit (njerëzve), si marrja e pasurisë me pa të drejtë, rrahja, ofendimi etj, atëherë duhet që patjetër t'i kthesh atij të drejtën si dhe ta bësh që të të falë e të jetë i kënaqur me ty. Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: "Kush i ka bërë padrejtësi ndonjë prej vëllëzërve të tij, atëherë le t'ia kërkojë atij hallallin, përpara se të vijë një kohë ku nuk do të ketë ar e as argjend". Muslimi.

**E pesta dhe e fundit:** është që pendimi të bëhet në kohë e të mos vonohet, pra të bëhet përpara se njeriut t'i dalë shpirti apo të lindë Dielli nga Perëndimi i tij.

Atëherë vëlla dhe ti o motër! Mos e vono pendimin, punën e sotme mos e lë për nesër, sepse e nesërmja sa është afër aq është dhe e pamundur për të ardhur për ty, sepse shpirti dhe jeta që ne posedojmë nuk është prona jonë, ndaj le të pendohemi të gjithë përderisa e kemi këtë shans.

*A nuk e kupton se mes teje dhe pendimit tashmë ka mbetur vetëm një hap! Atëherë hape derën e pendimit, bëhu dhe ti karvan i të penduarve dhe rrugë të mbarë në rrugëtimin tënd si i penduar në këtë muaj të bekuar.*

Nga hoxhë Bledar T. Haxhiu

## RAMAZANI, MUAJI I SOLIDARITETIT SOCIAL

Për jetimin i dërguari i Allahut (a.s.) thotë: "Unë dhe garantuesi i jetimit do të jemi kështu në Xhenet, dhe tregoi me dy gishtat e tij, treguesin dhe gishtin e mesëm". Buhari. Sadakaja e fitrit (zekati i fitrit) është një dispozitë nga dispozitat e muajit Ramazan pa të cilin nuk mund të plotësohet agjërimi i një besimtari.

Nëpërmjet kësaj sadakaje ne formë shpagimi, besimtarët pastrojnë veten e tyre nga gabimet e vogla që mund ti kenë kryer gjatë agjërimin të Ramazanit. Kjo sadaka është pjesë e pandarë e muajit Ramazan, por që ka një ndikim social- ekonomik në shoqëri. Kjo sadaka e ka origjinën në atë që thotë Zoti ynë në Kuran: "Dhe ata të pasurim, të cilët në pasurinë e tyre kanë një detyrim, kundrejt të varfërve dhe lypësve". Mearixh 24-25.

Një fenomen tjetër që sjell muaji i begatë i Ramazanit është dhe zekati, i cili është një nga pesë obligimet madhore islame. Shumë prej besimtarëve llogarinë e nxjerrjes së zekatit e bëjnë pikërisht në këtë muaj, ku veças punëve të mira që bëjnë, duan të fitojnë edhe shpërblimin e dhënies së zekatit. Kjo ndodh

në shumë vende islame dhe pothuajse është bërë traditë. I dërguari i Allahut (a.s.) thotë: Allahu i Madhëruar ka bërë obligim të nxirret nga pasuria e të pasurve muslimanë aq sa do tu mjaftojë të varfërve prej tyre, e nëse do të vuajnë nga uria, varfëria, kjo do të ndodhë për shkak të mosdhënies së zekatit. Për këtë ata do të kenë një llogari të fortë dhe ndëshkim të dhembshëm në ditën e gjykimit". Tabarani.

Një nga dispozitat e këtij muaji të begatë është dhe shpagimi i agjërimin për të gjithë ata që për shkak të pamundësisë shëndetësore nuk do të kenë mundësinë ta agjërojnë Ramazanin. Këtu bëhet fjalë për ata njerëz që nuk shpresojnë shërim të shpejtë ose të moshuarit e pafuqishëm për këtë obligim. Për këtë Zoti ynë thotë në Kuranin famëlartë: "Dhe për ata që nuk mundën dot të agjërojnë (Ramazanin) t'a shpagojnë me ushqim për të varfërit...." Bekare 184.

Shporta e Ramazanit, është një aktivitet human i cili është bërë gjithashtu tek muslimanët gjatë këtij muaji të begatë. Besimtarët solidarizohen me kontributet e tyre

modeste, por fisnike që për shtresën në nevojë është e domosdoshme dhe shumë me vlerë. Ky gjest fisnik bën që të varfërit të ndjehen mirë në mesin e vëllëzërve muslimanë dhe të kuptojnë fare mirë se ata nuk janë vetëm, por gëzojnë përkrahjen e vëllëzërve të tyre në fe. Kjo e bën jetën më të qetë e më të sigurtë në një kohë kur njerëzit jetojnë me ndjenjën e pasigurisë ekonomike dhe kjo për shkak të mungesës së solidaritetit dhe përkrahjes sociale në një shoqëri të zhveshur nga besimi dhe parimet hyjnore qiellore.

Përveç kësaj, gjatë këtij muaji besimtarët muslimanë nxiten të kontribuojnë sa më shumë ekonomikisht, pa e lidhur këtë kontribut me ndonjë kohë apo vend të caktuar, por jo vetëm. Ata mund të jenë aktivë edhe në aspekte të tjera sociale si vizita e të afërmeve, e të sëmurëve, e njerëzve në nevojë, përcjellja e xhenazës, kryerja e ndonjë halli e shumë punë të tjera të dobishme për shoqërinë. I dërguari i Zotit Muhamedi (a.s.) thotë: "Zoti do të jetë në ndihmë të robit të vet përderisa ai do të jetë në ndihmë të vëllait të tij". Ahmedi.

Të gjitha sa përmendëm janë punë të dobishme për individin si dhe për shoqërinë. Të gjitha punët e lartpërmendura nuk veprohen vetëm gjatë muajit Ramazan, por ato më së shumti kryhen në këtë muaj për shkak të nivelit të lartë të besimit dhe të moralit muslimanit, kur ai është agjërues.

Nëse do të vërejmë të gjitha detyrimet dhe shpagimet kanë të bëjnë me sadakanë, zekatin, si dhe ushqim për të varfërit, kjo na lë të kuptojmë se ky muaj përveç të mirave shpirtërore, na sjell dhe të mira sociale dhe ekonomike.

Ky muaj padyshim është një muaj i ngritjes shpirtërore dhe morale, por duke pasur pasqyrsh universalitetin e kësaj feje, ai nuk lë pas dore anën sociale dhe ekonomike. Kjo për arsye se muslimanët me fenë e tyre janë një ymet i mesëm dhe mesatar. Kjo do të thotë se në këtë fe universale dhe të drejtë nuk i jepet rëndësi diçkaje duke lënë në harresë dicka tjetër, anës shpirtërore ndaj asaj materiale. Kjo është drejtësi hyjnore e cila buron vetëm nga Krijuesi i drejtë, Allahu i Madhëruar.

Hoxhë Sokol Kondakciu

## Bar Restaurant Piceri "Ishulli Luanëve"

Në dalje të Tiranës, larg zhurmave të përditshme, në qetësinë dhe në ajrin e pastër, do të shijoni gatime tradicionale dhe hallall të guzhinës sonë.

Menu e pasur dhe një pamje piktoreske e lumit Erzen, e cila do t'ju mahnisë.

Ju mirëpresim!



Adresa: Rruga nacionale  
Tiranë-Durrës, Ndroq, km 17

Mobile: 00355 682153105

## PRODUKTE NATYRALE

*Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e lindjes!*



Adresa: Rr. e Kavajës,  
rrugica përballë  
xhamisë "Dine Hoxha", Tiranë  
Cel: 0672812607 / 0672821589

Produkte të firmës "Phenomenal", vaj të farës së zezë  
Mjaltë me polen, mjaltë sidri, etj.  
Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi  
Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe vajra bimore "Tact"  
Shampo bimore "Touch Me" nga Tajlanda  
Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojlojshme  
Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane  
Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak  
Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar  
Kohël bimor për sytë etj.

[www.produktenatyrale.com](http://www.produktenatyrale.com)  
Email: [agimballa@hotmail.com](mailto:agimballa@hotmail.com)

